

VENDIM
Nr.110, datë 22.2.2006

**PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT TË SIPËRFAQES 3100 m²,
PJESË E REPARTIT USHTARAK NR.5013, UZNOVË, BERAT, NGA MINISTRIA E
MBROJTJES TE KESH SHA DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.515, DATË
18.7.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË
INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË
NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, shkronja “c”, të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Sipërfaqes 3100 m², pjesë e pronës me numër rendor 1043 “Komanda e repartit ushtarak nr.5013”, me nr. pasurie 22/3, në zonën kadastrale e nr.8503, t’i ndryshojë përgjegjësia e administrimit nga Ministria e Mbrojtjes te KESH sh.a. për t’u përdorur për ndërtimin e nënstacionit të ri, 110/20 kV.

2. Sipërfaqja 3100 m², pjesë e pronës me numër rendor 1043 “Komanda e repartit ushtarak nr.5013”, të hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes.”

3. KESH sh.a. i ndalohet të ndryshojë destinacionin e përdorimit të sipërfaqes së përcaktuar në këtë vendim, si dhe ta tjetërsojë ose t’ua japë në përdorim të tretëve.

4. Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes, Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministri i Brendshëm, drejtori i KESH sh.a. dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha